



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 tetor 2024
Ref.nr.: RK2551/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI163/24

Parashtrues

Nysret Kabashi, Bajram Kabashi dhe Driton Kabashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC-I-0195-A0001 të 8 majit 2024,
të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Nysret Kabashi, Bajram Kabashi dhe Driton Kabashi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin [AC-I-24-0195-A0001] e 8 majit 2024 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), në ndërlidhje me Aktvendimin [C-III-22-0094] e 19 korrikut 2022 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 1 të Protokollit numër 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 korrik 2024, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
6. Më 13 gusht 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr.GJR.KI163/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
7. Më 15 gusht 2024, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës së parashtruesve të kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).
8. Më 25 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës për herë të dytë parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, Gjykata në veçanti do të paraqes gjendjen faktike për lëndën KI168-22, e cila është vendosur me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Më pastaj Gjykata do të paraqes gjendjen faktike të lëndës KI163-24 e cila është objekt shqyrtimi para Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve për lëndën KI168-22

10. Më 18 maj 2018, A.K., si pronar i “Petrol Kabashi” sh.p.k (në tekstin e mëtejme: “Petrol Kabashi”) kishte iniciuar procedurën e blerjes me negocim direkt me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) për blerjen e tri ngastrave kadastrale: 71914059-01530-0; P-71814059-01533-4; P-71814059-01533-6 (në tekstin e mëtejme: pronat kontestuese).
11. Më 28 shkurt 2020, Bordi i Drejtorëve të AKP-së aprovoi kërkesën e “Petrol Kabashi” për negocim direkt.
12. Më 27 maj 2020, AKP-ja përmes Vendimit [Ref.134/19] aprovoi shitjen e pronave kontestuese tek “Petrol Kabashi”.
13. Më 2 korrik 2020, parashtruesit e kërkesës dorëzuan ankesë në AKP kundër vendimit për shitjen e pronave kontestuese, me pretendimin se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për zbatimin e procedurës sipas negocimit direkt.
14. Më 16 dhjetor 2020, AKP-ja dhe “Petrol Kabashi”, nënshkruan Kontratë për shitjen dhe bartjen e pronave kontestuese.
15. Më 7 mars 2022, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesëpadi në DHPGJS dhe kërkuan anulimin e kontratës së shitjes për pronat kontestuese e lidhur ndërmjet AKP-së dhe “Petrol Kabashi”. Parashtruesit e kërkesës arsyetuan se: (i) “Petrol Kabashi” nuk ka pasur të drejtë të jetë blerës i vetëm në procedurën e negocimit direkt; (ii) gjatë negocimit, janë paraqitur të dhëna të pasakta; (iii) është shkelur parimi i barazisë së palëve. Parashtruesit e kërkesës paraqitën edhe propozim për masë të sigurimit ndaj pronave kontestuese, në mënyrë që ato të mos mund të tjetërsohen më tutje, deri në vendimin meritot për kërkesëpadinë.
16. Më 19 korrik 2022, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [C-III-22-0094] e aprovoi propozimin e masës së sigurisë ndaj pronave kontestuese dhe vendosi që “Petrol Kabashi” të mos ndërmarrë asnjë veprim për shitjen, tjetërsimin, dhënien me qira apo vënien në hipotekë të pronave kontestuese.
17. Më 27 korrik 2022 dhe 9 gusht 2022, AKP-ja dhe “Petrol Kabashi” paraqitën ankesa në Kolegjin e Apelit kundër aktvendimit të Kolegjit të Specializuar për caktimin e masës së sigurisë ndaj pronave kontestuese.
18. Më 22 shtator 2022, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I.-22-0418- AOOO1]: (i) aprovoi ankesat e AKP-së dhe “Petrol Kabashi”; (ii) ndryshoi aktvendimin e Kolegjit të Specializuar; dhe (iii) refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së sigurisë. Kolegji i Apelit konstatoi që nuk ishin plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara nga neni 61 i Ligjit për DHPGJSK-në, me arsyetimin se pronat kontestuese ishin transferuar tek personat e tretë dhe nuk kishte asnjë mundësi që ato të mbroheshin me një masë të sigurisë.
19. Më 7 nëntor 2022, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë në Gjykatë kundër Aktvendimit [AC-I.-22-0418- AOOO1] të Kolegjit të Apelit, me pretendimin se ishte në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, për shkak të mungesës së arsytimit gjyqësor.
20. Më 30 janar 2024, Gjykata përmes Aktgjykimit [KI168/22]: (i) konstatoi se Aktvendimi [AC-I.-22-0418- AOOO1] i Kolegjit të Apelit ishte në kundërshtim me nenin 31 të

Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së; (ii) shpalli të pavlefshëm dhe ktheu për rishqyrtim aktvendimin e Kolegjit të Apelit; dhe (iii) urdhëroi Kolegjin e Apelit që deri më 30 korrik 2024, të njoftonte Gjykatën për masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit. Gjykata arsyetoi se, Kolegji i Apelit nuk ofroi arsyetim të mjaftueshëm për refuzimin e masës së sigurisë; dhe nuk ofroi sqarime në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, të paraqitura përmes përgjigjes ndaj ankesave të AKP-së dhe “Petrol Kabashi”.

Përmbledhja e fakteve për lëndën KI163-24

(ii) Vendimi i Kolegjit të Apelit pas rishqyrtimit të rastit

21. Më 26 mars 2024, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesë në Kolegjin e Apelit dhe kërkuan zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës për të lënë në fuqi caktimin e masës së sigurisë. Parashtruesit e kërkesës theksuan se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për caktimin e masë së sigurisë ndaj pronave kontestuese. Ata pretenduan që kanë të drejtë mbi pronat kontestuese sepse janë bashkëposedues të atyre pronave, në të cilat i kanë objektet afariste.
22. Më 8 maj 2024, Kolegji i Apelit, pas rishqyrtimit, përmes Aktvendimit [AC-I-24-0195-A0001] vendosi: (i) të aprovojë ankesat e AKP-së dhe “Petrol Kabashi”; (ii) të ndryshojë Aktvendimin [C-III-22-0094] e Kolegjit të Specializuar; dhe (iii) të refuzojë si të pabazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë. Kolegji i Apelit theksoi se, bazuar në nenin 61 [Masat e sigurimit] të Ligjit Nr.06/L-086 për DHPGJS-në, që përcakton kriteret se kur duhet të lëshohet masa e sigurisë, pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se ekziston e drejta subjektive e kërkuar dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit vlerësoi se: (i) parashtruesit e kërkesës nuk kishin sjellë asnjë provë që dëshmon se ata mund të jenë pronar të pronave kontestuese. Sipas një vendimi të komunës së Fushë Kosovës, parashtruesit e kërkesës kishin të drejtë të shfrytëzonin pronat kontestuese përkohësisht. Pronat kontestuese ishin nën autoritetin administrativ të AKP-së, e cila ia shiti dhe i barti ato me një titull të vlefshëm pronësor tek “Petrol Kabashi”; (ii) “Petrol Kabashi” e fitoi pronësinë mbi pronat kontestuese mbi bazën e kontratës së shitblerjes me AKP-në, pra ka një titull pronësor dhe në këtë fazë nuk mund t’i kufizohen autorizimet ligjore në lidhje me titullin pronësor. Masa e sigurisë ka për qëllim që të mbrojtë diçka që ende mund të mbrohet. Në rastin konkret, nuk mund të arrijë një efekt të tillë sepse shitja veçse ka ndodhur dhe revokimi i kontratës së shitjes nuk mund të bëhet; (iii) refuzimi i masës së sigurisë nuk paragjykon zgjidhjen përfundimtare në lidhje me meritat e kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

(i) në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së

23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktvendimi [AC-I-24-0195-A0001] i Kolegjit të Apelit është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, për shkak të mungesës së arsytimit gjyqësor.
24. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se arsyetimi i aktvendimi i Kolegjit të Apelit është i gabuar, i pambështetur në rrethanat faktike dhe juridike të rastit dhe i pamjaftueshëm.

Sipas parashtruesve të kërkesës, arsyetimi i Kolegjit të Apelit nuk ndërlidhet me objektin e çështjes kontestuese dhe është arbitrar.

25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Kolegji i Apelit nuk i mori parasysh të gjeturat e Gjykatës në rastin KI168/22 dhe nuk i zbatoi urdhrat e saj në lidhje me këtë rast. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Kolegji i Apelit nuk i trajtoi fare dy çështjet kryesore, të cilat ishin konstatuar edhe nga Gjykata: se (i) ankesa e AKP-së nuk duhej trajtuar për shkak të mungesës së interesit juridik; dhe (ii) rrezikun për shkaktimin e dëmit për parashtruesit e kërkesës, meqë pronat kontestuese ishin bartur në emër të “Petrol Kabashi”.
26. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se, AKP-ja nuk kishte interes juridik për të bërë ankesë, sepse propozimi për masën e sigurisë kishte për qëllim që “Petrol Kabashi” të mos mund të tjetërsonte pronat kontestuese dhe kjo nuk lidhej fare me AKP-në. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se kishin ofruar argumente të mjaftueshme që ekziston se “Petrol Kabashi” do të mund të tjetërsonte pronat kontestuese, të cilat i fitoi sipas kontratës së shitblerjes me AKP-në.
27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që, në rishqyrtim, Kolegji i Apelit nuk mori parasysh urdhrat e Gjykatës por vetëm i shtoi disa paragrafë më shumë gjatë arsytimit. Pra, arsyetimi mbeti i njëjtë në kuptimin kualitativ, por vetëm u zgjerua më shumë me fjalë.

(ii) në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit numër 1 të KEDNj-së

28. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktvendimi i Kolegjit të Apelit shkeli të drejtat e tyre pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës. Sipas tyre, mungesa e arsytimit gjyqësor shkaktoi edhe cenimin e të drejtës së pronës, pra janë në ndërlidhje me njëra - tjetrën.
29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, kontrata e shitblerjes e lidhur ndërmjet AKP-së dhe “Petrol Kabashi”, me negociim direkt, ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe u pamundësoi atyre që të ishin pjesë e procedurës së negociimit direkt për blerjen e atyre pronave. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se pronat kontestuese i kishin shfrytëzuar për shumë vite dhe kishin ushtruar veprimtari ekonomike, prandaj pamundësia e blerjes së tyre përbën shkelje të së drejtës së pronës.
30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që, refuzimi i caktimit të masës së sigurisë rrezikon që pronat kontestuese të tjetërsohen nga “Petrol Kabashi”. Kjo do të pamundësonte realizimin e interesave pronësore të tyre ndaj pronave kontestuese dhe do të shkaktonte humbjen e tyre. Sipas parashtruesve të kërkesës, kompensimi financiar në një rast të tillë do të ishte i pamjaftueshëm për ta, sepse në pronat kontestuese ata ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe kanë interes për të vazhduar.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
[...]*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]

LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 61

[Masat e sigurimit]

1. Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë/padie. [...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[...]

33. Gjykata në vazhdim i referohet neneve 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

34. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; kontestojnë kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-24-0195-A0001] e 8 majit 2024, të Kolegjit të Apelit, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; kanë specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendojnë se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e kanë parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me paragrafin 2, të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

36. Sipas praktikës së GJEDNJ-së dhe Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në tërësinë e saj apo vetëm për ndonjë pretendim specifik. Pretendimet qartazi të pabazuara kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime të shkallës së katërt; (ii) pretendime me një mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes; (iii) pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara; dhe (iv) pretendime konfuzë dhe të paqarta (shih, rastet e Gjykatës, [KI107/21](#), parashtrues Ramiz Hoti, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 tetorit 2021; [KI21/21](#), parashtrues Asllan Meka, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 prillit 2021).

Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

37. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës dhe “Petrol Kabashi” i kishin shfrytëzuar së bashku pronat kontestuese për një periudhë të gjatë kohore, sipas një vendimi të komunës së Fushë-Kosovës që ia kishte njohur babait të tyre të drejtën për shfrytëzimin e përkohshëm të këtyre pronave. Megjithatë, pronat kontestuese kaluan nën administrimin e AKP-së, pasi ato i takonin ish-ndërmarrjes shoqërore “Bujësia”.

38. Gjykata vëren se “Petrol Kabashi”, si një nga ish-shfrytëzuesit e përbashkët të këtyre pronave, paraqiti kërkesë në AKP për të filluar negociimin direkt për blerjen e këtyre pronave. AKP-ja e miratoi propozimin dhe më pas e aprovoi shitjen e pronave kontestuese tek “Petrol Kabashi”. Në dhjetor të vitit 2020, AKP-ja dhe “Petrol Kabashi” nënshkruan kontratën për shitblerje dhe pronat kontestuese kaluan në pronësi të “Petrol Kabashi”.
39. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesëpadi në DHPGJS, duke kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes ndërmjet AKP-së dhe “Petrol Kabashi”. Ata pretenduan se “Petrol Kabashi” nuk kishte të drejtë të ishte blerësi i vetëm i pronave kontestuese me negociim direkt. Ata kërkuan poashtu caktimin e masës së sigurimit ndaj pronave kontestuese për të parandaluar tjetërsimin apo shitjen e tyre nga “Petrol Kabashi”.
40. Kolegji i Specializuar vendosi të caktojë masën e sigurimit ndaj pronave kontestuese dhe vendosi që “Petrol Kabashi” të mos ndër marrë asnjë veprim për shitjen, tjetërsimin, dhënien me qira, apo vënien në hipotekë të pronave kontestuese.
41. Gjykata vëren se, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I.-22-0418- AOOOI] të 22 shtatorit 2022, duke shqyrtuar ankesat e AKP-së dhe “Petrol Kabashi”, ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar dhe refuzoi caktimin e masës së sigurisë. Kolegji i Apelit arsyetoi se kushtet ligjore të përcaktuara nga neni 61 i Ligjit për DHPGJSK-në nuk ishin plotësuar, pasi pronat kontestuese kishin kaluar tek personat e tretë dhe nuk kishte mundësi për mbrojtje përmes masës së sigurimit.
42. Më 30 janar 2024, Gjykata përmes Aktgjykimit KI168/22, konstatoi se Aktvendimi [AC-I.-22-0418- AOOOI] i Kolegjit të Apelit i 22 shtatorit 2022 është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës për shkak të mungesës së arsyesimit gjyqësor. Gjykata kishte gjetur se Kolegji i Apelit nuk ofroi arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me: (i) shkaktimin e dëmit të pariparueshëm; dhe (ii) legjitimitetin procedural të AKP-së.
43. Pas aktgjykimit të Gjykatës, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan përsëri Kolegjit të Apelit dhe kërkuan që të zbatohet aktgjykimi i Gjykatës dhe të caktohet masa e sigurimit.
44. Kolegji i Apelit e rishqyrtoi çështjen pas vendimit të Gjykatës dhe më 8 maj 2024, përmes Aktvendimit [AC-I-24-0195-A0001] e refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit ndaj pronave kontestuese.
45. Gjykata vëren se, Kolegji i Apelit e njoftoi Gjykatën se parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur kërkesë të re për caktimin e masës së sigurimit më 5 qershor 2023. Kolegji i Specializuar përmes Aktvendimit të dytë [C-III-22-0094] të 25 korrikut 2023 e refuzoi kërkesën e re për caktimin e masës së sigurimit. Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I-23-0450] të 21 shtatorit 2023 e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktvendimin e shkallës së parë. Kolegji i Apelit theksoi se i kishte adresuar mjaftueshëm të gjitha pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre të dytë për caktimin e masës së sigurimit.
46. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar [C-III-22-0094] i 25 korrikut 2023 dhe Aktvendimi [AC-I-23-0450] i Kolegjit të Apelit i 21 shtatorit 2023 nuk janë objekt shqyrtimi i kushtetutshmërisë para Gjykatës. Gjykata nuk i merr në konsideratë këto aktvendime dhe nuk e vlerëson kushtetutshmërinë e tyre, sepse parashtruesit e kërkesës nuk i kanë kontestuar ato para Gjykatës. Gjykata do të shqyrtojë vetëm Aktvendimin [AC-I-24-0195-A0001] e Kolegjit të Apelit të 8 majit 2024, i cili përbën objekt shqyrtimi dhe kontestohet nga parashtruesit e kërkesës; dhe do të vlerësojë nëse i ka përmbushur të gjitha vërejtjet dhe të gjeturat e Gjykatës në rastin

KI168/22 në lidhje me: (i) shkaktimin e dëmit të riparueshëm; dhe (ii) legjitimitetin e AKP-së.

(i) nëse aktvendimi i Kolegjit të Apelit ofroi arsytetime për shkaktimin e dëmit të riparueshëm

47. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktvendimi [AC-I-24-0195-A0001] i Kolegjit të Apelit nuk ofroi arsytetime të mjaftueshme ligjore për refuzimin e masës së sigurimit ndaj pronave kontestuese. Ata theksojnë se Kolegji i Apelit, gjatë rishqyrtimit të çështjes, nuk mori parasysh të gjeturat e Gjykatës në rastin KI168/22.
48. Gjykata rithekson se, vendimet e gjykatave të rregullta duhet të theksojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato bazohen. Detyrimi për të dhënë arsye presupozon që palët në procedurat gjyqësore mund të presin të marrin përgjigje specifike dhe të qarta për argumentet që janë vendimtare për rezultatin e atyre procedurave. Shkalla në të cilën zbatohet detyra për të dhënë arsye mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (shih, rastin e GJEDNj-së, *Zayidov kundër Azerbejxhanit*, [nr.5386/10](#), Aktgjykim i 24 marsit 2022, paragrafi 91; shih, rastin e Gjykatës, [KI168/22](#), *parashtrues Nusret Kabashi, Bajram Kabashi dhe Driton Kabashi*, Aktgjykim i 30 janarit 2024, paragrafët 70-80).
49. Në rastin konkret, Kolegji i Apelit e rishqyrtoi çështjen pas vendimit të Gjykatës dhe përmes Aktvendimit [AC-I-24-0195-A0001] të 8 majit 2024 e refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit ndaj pronave kontestuese. Kolegji i Apelit arsyetoi se kriteret për caktimin e masës së sigurimit janë të përcaktuara sipas nenit 61 [Masat e sigurimit] të Ligjit për DHPGJSK-në. Sipas këtij neni, masa e sigurimit mund të caktohet kur të plotësohen dy kushte: së pari, parashtruesi duhet të jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij; së dyti, duhet të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Në lidhje me kushtin e parë, Kolegji i Apelit arsyetoi se parashtruesit e kërkesës nuk ofruan prova të besueshme se mund të jenë pronarë të pronave kontestuese. Parashtruesit e kërkesës kanë qenë shfrytëzues të përkohshëm të pronave kontestuese së bashku me “Petrol Kabashi”, por nuk ishin pronar të tyre. Kolegji i Apelit theksoi se ekziston një jurisprudencë e përgjithshme e Kolegjit të Apelit për zgjidhjen e këtyre rasteve në të cilën janë mbështetur.
50. Kolegji i Apelit arsyetoi se, AKP-ja ishte pronare e pronave kontestuese dhe kishte autoritetin për t’i administruar ato. Ajo i barti pronat kontestuese tek “Petrol Kabashi” sipas një kontrate të shitblerjes – e cila konsiderohet titull i vlefshëm pronësor. Kolegji i Apelit theksoi se “Petrol Kabashi” e fitoi pronësinë mbi bazën e një titulli të vlefshëm pronësor dhe nuk mund t’i kufizohen të drejtat pronësore me një masë sigurimi. Masa e sigurimit ka për qëllim të mbrojtë diçka që ende mund të mbrohet dhe në rastin konkret nuk mund të arrihet një efekt i tillë, sepse shitja ka ndodhur tashmë dhe nuk mund të riparohet një gjendje e tillë.
51. Gjykata vlerëson se kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit janë të përcaktuara nga neni 61 [Masa e sigurimit] i Ligjit të DHPGJSK-së, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Kriteri i parë për caktimin e masës së sigurimit është që pala të ofrojë dëshmi të besueshme për ekzistencën e të drejtës subjektive të tij. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës duhej të ofronin prova të besueshme që dëshmonin pronësinë ndaj pronave kontestuese. Siç argumentoi Kolegji i Apelit, parashtruesit e kërkesës nuk ishin pronarë të pronave kontestuese por vetëm i kishin shfrytëzuar përkohësisht ato, sipas një vendimi të komunës së Fushë-Kosovës. Edhe vetë parashtruesit e kërkesës e pranojnë faktin që ata nuk janë pronarë të pronave

kontestuese por vetëm pretendojnë blerjen e tyre në të ardhmen. Pra, nuk ishte plotësuar kushti i parë ligjor i përcaktuar nga neni 61 i ligjit të lartcekur.

52. AKP-ja, si pronare dhe administratore e pronave kontestuese, i shiti këto prona kontestuese të “Petrol Kabashi” nëpërmjet një kontrate shitblerjeje. Si rezultat, “Petrol Kabashi” e fitoi pronësinë mbi pronat kontestuese me një titull të vlefshëm pronësor. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesës kërkuan anulimin e kontratës së shitblerjes për shkak të pretendimeve se ajo ishte lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore. Megjithatë, kërkesa për anulimin e kontratës dhe propozimi për masën e sigurimit janë dy çështje të ndara ligjore. Kështu, gjykatat e rregullta mund të refuzojnë masën e sigurimit duke u bazuar në kriteret ligjore, por ende të vendosin në favor të kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës. Kolegji i Apelit e theksoi këtë fakt, duke sqaruar se refuzimi i masës së sigurimit nuk i paragjykon meritat e kërkesëpadisë. Kolegji i Apelit arsyetoi se “Petrol Kabashi” kishte një titull të vlefshëm pronësor dhe nuk mund të kufizoheshin të drejtat e tij me masën e sigurimit. Pra, çështja e kalimit të pronësisë kishte përfunduar dhe nuk mund të revokohej përmes masës së sigurimit. Anulimi i kontratës së shitblerjes mund të arrihet vetëm përmes një vendimi mbi meritat e kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës.

(ii) në lidhje me legjitimitetin e AKP-së

53. Parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur padi në DHPGJS kundër dy të paditurve: AKP-së dhe “Petrol Kabashi”. Ata kërkuan anulimin e kontratës së shitblerjes për pronat kontestuese që e kishin lidhur të paditurit dhe propozuan caktimin e masës së sigurimit.
54. Kur Kolegji i Specializuar miratoi propozimin e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, AKP-ja dhe “Petrol Kabashi” paraqitën ankesë në Kolegjin e Apelit kundër aktvendimit të Kolegjit të Specializuar.
55. Gjykata vëren se, parashtruesit e kërkesës ngritën pretendimin se AKP-ja nuk kishte legjitimitet për të ushtruar ankesë sepse pronat kontestuese ishin bartur të “Petrol Kabashi” dhe masa e sigurimit kërkohej ndaj pronave që tashmë ishin në pronësi të kësaj të fundit.
56. Gjykata vëren se, Kolegji i Apelit edhe në rishqyrtim nuk e adresoi çështjen e legjitimitetit të AKP-së për të ushtruar ankesë kundër aktvendimit të Kolegjit të Specializuar për caktimin e masës së sigurimit. Megjithatë, Gjykata konsideron se AKP-ja e kishte statusin e palës së paditur sepse parashtruesit e kërkesës vet e kishin paditur AKP-në në kërkesëpadinë e tyre duke e konsideruar palë në këtë çështje. Është e pritshme që AKP-ja si e paditur të ushtronte ankesë pranë Kolegjit të Apelit për të mbrojtur interesat e saj juridike. Për më tepër, ankesë kishte ushtruar edhe “Petrol Kabashi” dhe jo vetëm AKP-ja. Rrjedhimisht, vendimi i Kolegjit të Apelit nuk u bazua vetëm në ankesën e AKP-së por edhe të “Petrol Kabashit”. Edhe sikur të mos kishte fare legjitimitet AKP-ja, kjo gjë nuk do të ndikonte në rezultatin e vendimmarrjes.
57. Gjykata thekson se, gjykatat e rregullta nuk e kanë detyrimin të japin vlerësime për çdo çështje që e ngritin palët. Sidomos në rastet kur është e dukshme se pretendimet e palëve nuk janë të mbështetura ligjërisht dhe as të rëndësishme në rezultatin e procesit gjyqësor. Në rastin konkret, çështja e legjitimitetit të AKP-së ishte një pretendim dukshëm i parëndësishëm dhe jo vendimtar për zgjidhjen e çështjes.

(iii) përfundime

58. Gjykata rithekson se nuk ka juridiksion për të zëvendësuar vlerësimet e gjykatave të rregullta në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ligjit. Në rastin konkret, caktimi apo

jo i masës së sigurimit është detyrë e gjykatave të rregullta, të cilat i vlerësojnë kriteret ligjore në përputhje me faktet e rastit.

59. Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit, në rishqyrtim, ofroi arsyetime të qarta dhe të mjaftueshme se nuk plotësoheshin kushtet ligjore të përcaktuara nga Ligji për DHPGJSK-në, për caktimin e masës së sigurimit. Nuk ka asnjë çështje e cila ka mbetur e pa arsyetuar, e që do të mund të ishte përcaktuese për rezultatin e vendimit.
60. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me mungesën e arsytimit ligjor të aktvendimit të Kolegjit të Apelit, i përkasin pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe refuzohen si qartazi të pabazuara.

Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së

61. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktvendimi [AC-I-24-0195-A0001] i Kolegjit të Apelit është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës, sepse refuzimi i caktimit të masës së sigurimit ka cenuar të drejtat pronësore të parashtruesve të kërkesës mbi pronat kontestuese. Sipas parashtruesve të kërkesës, kontrata e shitblerjes e lidhur ndërmjet AKP-së dhe “Petrol Kabashi” me negociim direkt, u pamundësoi atyre të ishin pjesë e procesit për blerjen e pronave kontestuese të cilat i kishin shfrytëzuar për shumë vite dhe kishin ushtruar veprimtari ekonomike.
62. Gjykata rithekson se, kuptimi i “pronës” i garantuar nga neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së, përfshin pasuritë ekzistuese, ose pasuritë, në lidhje me të cilat një kërkues mund të argumentojnë se ai ka të paktën një “pritshmëri legjitime” se ato do të realizohen (shih, rasti i GJEDNJ-së, *Peter Gratzinger dhe Eva Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë*, [nr. 39794/98](#), Vendim i 10 korrikut 2002, paragrafi 69). Neni 1 i Protokollit numër 1 të KEDNJ-së nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës (shih, rasti i Gjykatës, *parashtrues Alban Miftaraj*, [K1189/19](#), Aktvendim për papranueshmëri i 10 nëntorit 2020, paragrafi 85).
63. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kërkuan anulimin e kontratës së shitblerjes së pronave kontestuese ndërmjet AKP-së dhe “Petrol Kabashi”, me pretendimin se ishte lidhur në kundërshtim me rregullat ligjore. Parashtruesit e kërkesës i kishin shfrytëzuar pronat kontestuese për një periudhë të gjatë kohore por nuk ishin pronarë të tyre.
64. Gjykata vlerëson se, parashtruesit e kërkesës nuk janë pronarë të pronave kontestuese por vetëm pretendojnë që në të ardhmen të jenë pronarë të atyre pronave, sipas një kontrate të mundshme me AKP-në. Kjo nuk është kontestuese. Pra, nuk bëhet fjalë për pasuri ekzistuese të parashtruesve të kërkesës, por vetëm me shpresa se në të ardhmen mund të bëhen pronar të pronave kontestuese.
65. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës se aktvendimi i Kolegjit të Apelit është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, prandaj shpallen si qartazi të pabazuara.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, në Gazetën Zyrtare;
- IV. TË KONSTATOJË që ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.


Gjyqtari raportues



Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani